

Këngët partizane. Trashëgimia shpirtërore e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Vasil S. Tole, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2025.

Përshëndetje!

Në radhë të parë, më lejoni të shpreh kënaqësinë që jam i pranishëm sot në këtë auditor për të promovuar një punë studimore kushtuar një pjese me vlerë të trashëgimisë sonë muzikore e kulturore siç janë këngët partizane, aq më tepër kur një punë e tillë është kryer nga prof. Vasil Tole, i cili është prej vitesh një prej studiuesve më aktivë e më të përkushtuar të kësaj trashëgimie.

Në retrospektivë duket krejt e natyrshme e madje do të thoja e pashmangshme që herët a vonë kënga partizane do të zinte tryezën e punës së profesorit. Ai është marrë mjaft me Himnin Kombëtar, me këngët patriotike, që në një kuptim janë pararendëset historike të këngëve partizane apo edhe me Dhora Lekën, autoren emblematike të këngës partizane shqiptare. Në këtë kuptim, libri që kemi në dorë nuk është një shteg i ndjekur rastësisht por stacion logjik përgjatë një rruge të njohur e të shkelur me kujdes prej kohësh.

Kënga partizane nuk është një fenomen vetëm shqiptar. Pas rënies së murit të Berlinit dhe ndryshimeve të sistemeve politike, në vendet e ish-bllokut të lindjes pati një shpërfillje e madje nënçmim të trashëgimisë antifashiste duke e lidhur me socializmin që pasoi. Prandaj edhe këngët partizane, si trashëgimi dhe gjini muzikore kryesore e lëvizjes antifashiste të Luftës II Botërore u lanë në harresë, u shpërfillën, u heshtën, u nënçmuan. Edhe Shqipëria nuk bën aspak përjashtim në këtë drejtim.

Në atmosferën politike e kulturore ku jetojmë sot, polarizimi shfaqet si një nga problemet e kërcënimit më të mëdha. Prandaj, në vend që të ngulmojmë mbi dallimet, duhet të kërkojmë të përbashkëtat mbi bazën e të cilave mund të ndërtojmë dialog e mirëkuptim të ndërsjelltë. Dhe është detyrë parësore e studiuesit që të kontribuojë në këtë drejtim, duke punuar pa paragjykime, me imtësi e ndershmëri, përtej himnizimit apo stigmatizimit gjithëpërfshirës e të padiferencuar. Më duket se prof. Vaso e ka gjetur një shteg të tillë në lidhje me këngën partizane shqiptare, në dallimin e qartë që bën ndërmjet antifashizmit dhe socializmit që pasoi. Vlerësimi i tij se “ndikimi ideologjik nuk ishte i pranishëm në tërësinë e këngëve partizane” (f. 30) shkon pikërisht në këtë linjë, duke nënvizuar se ato lindësi produkt i një ideali mbarënjëzësor të lirisë e dinjitetit, dhe jo si mjet indoktrinimi apo në funksion të

pushtetit politik. Nëse më vonë ato u përdorën nga sistemi për të fituar legjitimitet politik, kjo nuk i cënon ato *në vetvete*. Për të dhënë një shembull të famshëm, fakti që u përdorën nga nazistët në shek. XX as nuk i delegjtimon dhe as nuk ua ul vlerën veprave të Beethovenit në vetvete.

Vepra që kemi sot në dorë ka një qëllim të thjeshtë por shumë të rëndësishëm: mbledhjen dhe dokumentimin e gjithë repertorit të njohur të këngëve partizane, duke adresuar kështu problemin e mprehtë të gjendjes fragmentare dhe rrezikun e humbjes së pjesëve të tij. Dokumentimi me tekste e notizim muzikor i të gjithë repertorit në një përmbledhje të vetme e bën këtë libër një pikë reference për çdo hulumtim të mëtejshëm të këngës partizane në pikëpamje studimore por edhe në pikëpamje të punës kulturore, në kuptimin e rigjallërimit apo shfrytëzimit e përpunimit krijues të njësive të caktuara të saj.

Libri nis me një hyrje jo shumë të gjatë por mjaft grishëse në të cilën janë ngjeshur një sërë të dhënash e idesh që duket sikur janë përpiluar enkas për të të nxitur të kërkosësh e të thellohesh më tej në to. Që në fillim, për shembull, autori shtron një tezë interesante duke e cilësuar këngën partizane si “pjesë të pandashme të trashëgimisë muzikore shpirtërore patriotike të popullit shqiptar” (f. 10), duke nënvizuar një vijimësi të zhvillimeve në këtë gjini në harkun kohor 1878-1945.

Më tej ai bën një panoramë konçize të përdorimit të muzikës nga të gjitha palët ndërluftuese në Luftën II Botërore, duke u përqendruar tek Gjermania naziste, Amerika dhe Bashkimi sovjetik. Duke u kthyer në kontekstin shqiptar, autori nënvizon sesi këngët e para me tematikë kundër pushtimit fashist qenë një numër krijimesh popullore/tradicionale, dhe lista e këngëve që përcjell dëshmon për interesin e gjatë dhe njohjen e gjerë që ka për folklorin muzikor shqiptar.

Pas kësaj, ai trajton gjerësisht harkun kohor të krijimit të këngëve partizane, 1942-45, autorët kryesorë (mbi të gjitha Dhora Lekën), kontekstet e krijimit, të interpretimit e të qarkullimit të këngëve, e shumë aspekte të tjera me interes. Këto shkojnë nga fakte thujse anekdotike si rrëmbimi i pajisjeve teknologjike në Radio Korça dhe regjistrimi i këngëve në disqe gramafoni (f. 24), (apo fakti sesi edhe Orkestra Frymore e Ushtrisë Popullore u krijua më 1944 gjithashtu duke rrëmbyer instrumentet dhe arkivën muzikore të ish-bandës muzikore ushtarake të Mbretit Zog [f. 27]), deri tek oraliteti si mënyrë krijimi e qarkullimi e këngëve dhe përshtatjet e ndryshimet që ato pësuan gjatë atij procesi (f. 24). Të gjitha së bashku

krijojnë një panoramë shumë të gjallë të kontekstit ku u krijuan e qarkulluan këngët partizane.

Në fund autori argumenton kundër tezave që e reduktojnë këngën partizane vetëm në ideologji. Vërtet ai e konstaton praninë ideologjike në ndonjë prej këngëve të përmbledhura, por ngulmon se ato janë një fenomen anësor dhe assesi thelb i këngës partizane në tërësi.

Në pjesën e dytë, pas Himnit Kombëtar (të paraqitur në tre variante: vokal, për orkestër simfonike dhe për orkestër frymore), paraqiten notizimet e këngëve partizane të ndara në tre blloqe kryesore: I. Këngë partizane, II. Këngë kushtuar dëshmorëve, III. Këngë kushtuar formacioneve luftarake partizane, përkatësisht me 21, 14 dhe 13 këngë secili (gjithsej, 48 këngë). Mjaft prej tyre janë të plotësuar me shënime plotësuese që kanë të bëjnë me autorësinë (në rastet kur dihen), kohën dhe kontekstin e krijimit, personazhet që ato u kushtohen, etj. Për rastet kur ka regjistrime në rrjet, notizimet janë pajisur edhe kodet përkatëse të skanimit përmes të cilave këngët mund të konsultohen në kohë reale në formën e tyre të plotë (dihet që notizimi jep një pasqyrë gjithësi të pjesshme të fenomenit muzikor), diçka që ia shton vlerën botimit.

Pjesa e tretë, e titulluar *Lufta dhe kënga: tabelë kronologjike (1939-1945)* përmbledh në formë konspekti zhvillime kryesore politike dhe ushtarake të Luftës II Botërore dhe momente të rëndësishme të muzikës shqiptare të kohës. Pjesa e fundit, që paraqitet si shtojcë, përcjell 25 notizime këngësh folklorike me temë nga lufta antifashistete marra nga botimet e dikurshme të Institutit të Kulturës Popullore.

Në përmbyllje mund të thuhet se libri *Kënga partizane. Trashëgimia shpirtërore e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare* i Vasil Toles përbën një kontribut në disa aspekte. Në radhë të parë ai ruan dhe dokumenton një repertor prej kohësh të lënë pas dore. Ai është i pasur me të dhëna dhe ka ç't'i ofrojë jo vetëm studiuesit të muzikës por edhe historianëve e studiuesve të kulturës shqiptare në tërësi, sidomos atyre të interesuar për periudhën e Luftës II Botërore. Libri shtron themelin dhe ngacmon për punë të mëtejshme studimore të këtij repertori. Ai argumenton në mënyrë të matur përkundrejt gjykimeve drastike që shfaqen nganjëherë në lidhje me trashëgiminë socialiste (si në debatin e disa viteve më parë kur propozohej të hidhej në kosh e gjithë kinematografia shqiptare e asaj periudhe) duke e “rehabilituar” këngën partizane si “trashëgimi shpirtërore të Luftës Antifashiste.”

Duhet theksuar se kjo trashëgimi muzikore ka rrezatuar edhe në muzikën e kultivuar shqiptare, në vepra të autorëve si Nikolla Zoraqi, Tonin Harapi e të tjerë, prandaj qëndrimi

kategorikisht mohues i këngës partizane është varfërues edhe për muzikën e kultivuar shqiptare në tërësi.

Në fund dua ta mbyll këtë parashtrim me fjalët e Albert Papis, themeluesit të muzikologjisë shqiptare, i cili kujtonte sesi një personalitet i muzikës ruse të kohës, drejtori i konservatorit të Moskës Svezhoikov, në një artikull për Dhora Lekën shprehej për këngët e saj partizane se “ato hyjnë pa asnjë ngurrim në fondin më të mirë të këngëve revolucionare botërore.”

Edmir Ballgjati

Tiranë, më 27.11.2025